Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Industrije,Preduzetništva, Trgovine i Inovacija - Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade and Innovation

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency

Thirrje publike për aplikim në stendën shtetërore të Kosovës në panairin "Sial Paris 2026"

17-21 tetor 2026
Adresa: Paris, Francë

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare të sektorit të ushqimit dhe pijeve, në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport të shërbimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset të aplikojnë përmes kësaj thirrje që të jenë pjesë e këtij aktiviteti ndërkombëtarë. KIESA mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e stendës, regjistrimin e 8 subjekteve pjesëmarrëse, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse. Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 21.08.2026. Dokumentet e plotësuara si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës (kërkohet: certifikata e regjistrimit me informatat mbi biznesin);
3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
4. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
5. Deklaratën nën betim;

6. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2025 nga Administrata Tatimore e Kosovës (kërkohet: Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera nga ATK); dhe
7. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK, jo më e vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet. Për ketë aktivitetet sipas kritereve në vijim dhe vlerësimit të pikëve do të përzgjidhen 8 subjekte, nëse aplikojnë më shumë subjekte të përgjegjshme do të përpilohet edhe lista rezervë në mënyrë që të zëvendësohet sipas vlerësimit nëse ndonjëra kompani tërhiqet për çfarëdo arsye:

Kriteret e vlerësimit:

- Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum 10 pikë:
    - 1 pikë për 1 produkt
    - 3 pikë për 2 produkte
    - 5 pikë për 3 produkte
    - 7 pikë për 4 produkte dhe
    - 10 pikë për 5 e më shumë produkte.

- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
    - Gjuhë Angleze 5 pikë
    - Gjuhë Frenge 4 pikë dhe
    - Gjuhë tjera 1 pikë.

- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
    - Gjuhë Angleze 4 pikë
    - Gjuhë Frenge 4 pikë dhe
    - Gjuhë tjera 2 pikë.

- Shtetet ku janë eksportuar shërbimet e subjektit aplikues gjatë vitit 2025, maksimum 10 pikë:
    - Shtetet e BE-së 5 pikë
    - Shtetet e CEFTA-së 3 pikë dhe
    - Shtetet tjera 2 pikë.

- Certifikime ndërkombëtare të subjektit, maksimum 5 pikë:
    - ISO 3 pikë dhe
    - Certifikime tjera 2 pikë.

- Paraqitja e subjektit aplikues në panaire apo dhe B2B takime në 5 vitet e fundit, maksimum 5 pikë:
    - 1 deri në 3 panaire 3 pikë dhe
    - 4 deri në 6 panaire 5 pikë.

- Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2025, maksimumi 10 pikë:
    - 0 - 500.000 euro 4 pikë
    - 500,001 – 1,000,000 euro 8 pikë dhe
    - > 1,000.000 euro 10 pikë.

Më 18.08.2026, në ora 10:00, në sallën e takimeve të MINTI, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në ketë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në ketë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashkë me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 21.08.2026 në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në MINTI-KIESA apo të shkarkohen nga faqet e internetit: minti.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net